



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË SHTËRPCËS PËR VITIN 2021

Prishtinë, maj 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Shtërpcës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Shtërpcës (Komuna e Shtërpcës), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Shtërpcës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

A1 Komuna nuk kishte regjistruar në regjistrat kontabël të SIMFK-së blerjet e vitit 2021 që janë bërë nga kategoria e investimeve kapitale në vlerë prej 388,168€. Po ashtu, Komuna nuk e aplikon sistemin e-pasuria për regjistrimin e pasurive nën 1,000€, blerjet e vitit në vlerë 119,771€, nuk janë regjistruar në sistemin e-pasuria, duke bërë që vlera e pasurive kapitale dhe jo kapitale të mos jetë e shpalosur saktë në PFV.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Shtërpçës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B1 Komisioni i inventarizimit nuk kishte përgatitur ndonjë raport për gjendjen e inventarizimit para përgatitjes së PFV.
- B2 Vlera e përgjithshme origjinale e pajisjeve mjekësore në regjistrin e pasurisë është 1,823,644€, të cilat mbahen në depo, nuk shfrytëzohen, zhvlerësohen dhe për disa prej tyre vlera e mbetur në libra është zero.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Shtërpçës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Shtërpcës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Shtërpcës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Shtërpcës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Shtërpcës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të mundshme, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit, dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: të hyrat, obligimet, të arkëtueshmet si dhe pasuritë jo financiare, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të përmirsojnë informacionin financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me gjashtë (6) rekomandime, prej tyre dy (2) janë rekomandime të reja dhe katër (4) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Mos regjistrimi i pasurive në regjistrat përkatës si dhe prezentimi i plotë i tyre në PFV

Gjetja Sipas Rregullores Nr 02/2013 - “Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore”, neni 6, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”, po neni ashtu 6 i Rregullores MF.nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: “Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Komuna nuk kishte regjistruar në regjistrat kontabël të SIMFK-së blerjet e vitit 2021 që janë bërë nga kategoria e investimeve kapitale në vlerë prej 388,168€ (ku përfshihen paisjet mjeksore me vlerë prej 330,406€ si dhe ndërtimi i rrugëve lokale me vlerë 57,762€). Po ashtu, Komuna nuk e aplikon sistemin e-pasuria për regjistrimin e pasurive nën 1,000€, blerjet e vitit në vlerë 119,771€ ku përfshihen blerja e kompjuterëve, inventarë të ndryshëm dhe paisje tjera të IT-së të cilat nuk janë regjistruar në sistemin e-pasuria, duke bërë që vlera e pasurive kapitale dhe jo kapitale të mos jetë e shpalosur saktë në PFV.

Shkaku përse ka ndodhur kjo është mungesa e kontrolleve të brendshme rreth menaxhimit të pasurive.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurive në regjistrat përkatës si dhe mos prezentimi i tyre në PFV-të ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PFV-ve të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën e pasurive të organizatës buxhetore.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e blera të regjistrohen konform rregullës për menaxhimin e pasurive, në mënyrë që prezentimi i tyre në PFV të jetë i saktë dhe i plotë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B1 - Mos inventarizimi i pasurive jo financiare

- Gjetja** Sipas Rregullores me Nr. 02/2013 - Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 19 paragrafi 4.6 dhe 4.7, kërkon që “Komisioni i inventarizimit të përgatitë raportin për kryerjen e inventarizimit” si dhe komisioni është përgjegjës gjithashtu që “Hartimi i raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të komisionit për inventarizimin e pasurive jo financiare të bëhet në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore”. Ky proces duhet ti paraprij përgatitjes së PFV-ve.
- Komisioni për inventarizim të pasurive ishte formuar me vendim të kryetarit të komunës me dt. 11.05.2021. Mirëpo, komisioni nuk kishte përgatitur ndonjë raport për gjendjen e inventarizimit para përgatitjes së PFV.
- Menaxhmenti nuk e ka trajtuar me kujdes çështjen e pasurive, kjo tregon mungesë të kontrollit të brendshëm në komunë dhe si rezultat i kësaj gjendja e pasurive në komunë është në nivel të ulët të menaxhimit.
- Ndikimi** Mos përgatitja e raportit të inventarizimit brenda afatit të paraparë, ndikon që prezantimi i pasurisë në regjistrat e Komunës dhe në pasqyrat financiar vjetore të mos jetë i saktë dhe i plotë, po ashtu rrezikon humbjen apo përvetësimin e pasurisë.
- Rekomandimi B1** Kryetari duhet të analizoj arsyet se pse nuk janë kryer veprimet e përcaktuara me vendim dhe të kërkoj përgjegjësi nga zyrtaret përgjegjës të emëruar që procesi i inventarizimit të kryhet me kohë, me qëllim të prezantimit të saktë dhe të drejtë në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Menaxhim jo i duhur i pasurive

- Gjetja** Sipas nenit 2.1 të Rregullores 02/2013, të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare me qëllim të menaxhimit efektiv, efikas, ekonomik dhe me qëllim të mbrojtjes së pasurisë jo financiare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.

Vlera e përgjithshme origjinale e pajisjeve mjekësore në regjistrin e pasurisë është 1,823,644€, të cilat mbahen në depo, nuk shfrytëzohen, zhvlerësohen dhe për disa prej tyre vlera e mbetur në libra është zero. Zhvlerësimi për këto pajisje në fund të vitit 2021 ka vlerën prej 1,214,173€, ndërsa vlera e mbetur në libra është 609,471€.

Komuna ka ndërtuar një Spital, kostoja e të cilit arrinë vlerën prej 1,647,257€. Pranimi teknik është bërë me dt.31.10.2012 dhe i cili ende nuk është funksionalizuar dhe i njëjti ka filluar të zhvlerësohet që nga data e

pranimit teknik. Zhvlerësimi i akumuluar i kësaj ndërtese deri në fund të vitit 2021 ka arritur vlerën prej 377,473€, ndërsa vlera neto në libra ka mbetur 1,269,684€.

Në regjistrin e pasurive të komunës janë të evidentuara katër ndërtesa banimi, të ndërtuara për qytetar me gjendje të rëndë sociale, në vlerë prej 2,709,075€. Edhe pse ndërtesat janë të përfunduara para më shumë se 6 viteve ato ende janë të pashfrytëzuara, nuk janë të pranuar teknikisht, mbahen si investime në vijim dhe nuk zhvlerësohen. Këto ndërtesa nuk shfrytëzohen nga askush, nuk kanë përkujdesje dhe nuk mirëmbahen.

Nga vizita e realizuar kemi vërejtur se këto ndërtesa kanë filluar të dëmtohen dhe të demoloohen.

Shkaku për se ka ardhur deri te kjo është neglizhenca, papërgjegjësia e menaxhmentit dhe mungesa e kontolleve të brendëshme për ti korgjuarë çështet më lartë.

Ndikimi

Mbajtja e pajisjeve në depo për kohë të gjatë dhe mos funksionalizimi i tyre ndikon në zhvlerësimin e tyre ende pa u përdorur. Po ashtu, kjo ndikon edhe në dëmtimin fizik për shkak të kushteve të pa përshtatshme të ruajtjes së tyre dhe paraqet rrezik nga keq përdorimet dhe përvetësimet e paligjshme. Më tutje, mos pranimit teknik, mos lëshimi në punë dhe menaxhimi i tillë i ndërtesave rritë rrezikun që ato të dëmtohen dhe të rritet kostoja e kthimit të tyre në gjendje për përdorim.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë që kërkesat për blerjen e pajisjeve dhe planifikimi i nevojave për prokurim të jenë analizuar mirë dhe në përputhje me krijimin e parakushteve për funksionalizimin e tyre, duke pasur parasysh gjithnjë vlerën për paranë. Më tutje, duhet të merren masa urgjente që të krijohen parakushtet që pajisjet që gjenden në depo dhe ndërtesat e banimit social të futen sa më shpejt në përdorim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna e Shtërpcës në 2021 ishin në vlerë 353,361€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga regjistrimi i trashëgimisë, taksat administrative, etj. Përveç të hyrave të lartpërmendura, Komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat mbledhen nga niveli qendror në vlerë prej 56,982€ (gjobat në trafik 38,429€, gjobat nga Agjencia e pyjeve 17,082€, si dhe nga Gjykata 1,470€).

Çështja B3 - Mos shpërndarja e faturave / aktvendimeve për taksën në biznes

Gjetja	<p>Sipas Nenit 3 të Rregullores komunale për taksa, kërkohet që pas regjistrimit të veprimtarisë afariste përcaktohet shuma vjetore e taksës me aktvendim dhe i dorëzohet subjekteve afariste më së voni një muaj para fillimit të vitit kalendarik.</p> <p>Komuna e Shtërpcës nuk kishte shpërndarë te bizneset aktvendimet / faturat për taksë në biznes për vitin 2021 dhe nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim për zbatimin e rekomandimit të dhënë në auditimin paraparak.</p> <p>Kjo gjendje vazhdon të jetë për shkak të neglizhencës së zyrtarëve përgjegjës.</p>
Ndikimi	<p>Mosrespektimi i rregullores lidhur me shpërndarjen e faturave (aktvendimeve) për taksën në biznes ndikon direkt në uljen e të hyrave, gjë që rezulton në fonde më të vogla të Komunës për të arritur objektivat e planifikuara.</p>
Rekomandimi B3	<p>Kryetari duhet të sigurojë që zyrtarët përgjegjës janë duke i kryer detyrat dhe përgjegjësitë në lidhje me faturimin e taksës së biznesit dhe dorëzimin e faturave/aktvendimeve te subjektet afariste.</p>

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Të arkëtueshmet

OB-ja në PFV-të e vitit 2021 ka shpalosur Llogari të Arkëtueshme (LL.A) në vlerë prej 3,029,583€. Kjo vlerë përbehet nga LI.A për tatimin në pronë 2,814,403€ dhe taksat vjetore të bizneseve në vlerë prej 215,180€.

Çështja B4 - Menaxhim jo i duhur i llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme me nenin 30 pika 1 është përcaktuar se nëse pas njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve kalendarike nga dita e fundit për pagesë, në përputhje me paragrafin 1. të nenit 27 të këtij Ligji, pagesa ende nuk është bërë, komuna merr vendim mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara që kanë kaluar shumën e treqind (300€). Vendimi merret brenda dhjetë (10) ditëve pune.

Gjithashtu sipas rregullores mbi taksat, tarifat dhe ndëshkimet komunale, neni 3, taksa për ushtrimin e veprimtarisë afariste, pika 3 i obligon subjektet afariste që të paguajnë të gjitha obligimet financiare nga vitet paraprake, njëherit neni 27 parasheh dënime për mos respektim të dispozitave të rregullores komunale në fjalë.

Nga 70 mostrat e testuara për LI.A, 20 prej tyre për tatimin në pronë, për të gjitha këto raste, borgjet ishin mbi 300€ (për secilin), si obligime të pa shlyera ndaj Komunës, po ashtu për taksën në biznes 17 raste në vlerën prej 31,600€, biznese nuk i kishin shlyer obligimet ndaj komunës për vite me radhë.

Komuna, megjithatë, në asnjë rast nuk ka iniciuar procedurë të arkëtimit të detyrueshëm, për këtë arsye të arkëtueshmet po rriten nga viti në vit, dhe nese e krahasojme me vitin 2020 ku vlera e LI.A ishte 2,591,936€, në vitin 2021 është 3,029,583€, ku shihet se ka një rritje për rreth 437,647€ apo 15%.

Gjatë auditimit të taksat për kryerjen e aktiviteteve afariste, kemi konstatuar se komuna për vitin 2021 nuk u ka përcjellë lejet për ushtrimin e veprimtarisë subjekteve afariste. Lidhur me këtë kemi bërë një rishikim të detajuar të data bazës së llogarive dhe është konstatuar se baza e të dhënave është plotësisht jo e besueshme për shkak se disa biznese nuk janë përfshirë në bazën e të dhënave. Data baza përmban një numër të madh të gabimeve dhe për shkak se ngarkesa është bërë në mënyrë paushalle nga viti në vit, pa u vërtetuar statusi i subjektit afarist.

Për shkakë të mos kryerjes së detyrave me përgjegjësi si duhet zyrtarët përgjegjës për mbajtjen e evidencës së të arkëtueshmeve me jo efektivitetin dhe mos efikasitetin në punë, nuk u kanë dorëzuar obliguesve paralajmërimet e fundit para mbledhjes së detyrueshme, që si pasoj ka ardhur deri te mos shlyerja detyrimeve vite me radhë.

Ndikimi

Mos zbatimi i ligjit dhe rregulloreve që i japin komunës mekanizma për inkasimin e të arkëtueshmeve, ndikon në rritjen e vazhdueshme të shumës së të arkëtueshmeve, në pamundësinë e realizimit të planeve komunale, si dhe inkurajon borxhlinjët tjerë që të mos përmbushin obligimet e tyre.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të marrë masat e nevojshme për shtuar përgjegjësinë ndaj zyrtarëve përkatës për zbatimin e rregullave, në mënyrë që të rrisin

arkëtimin e borxheve dhe ndalojnë rritjen e vazhdueshme të L.I.A, si dhe të sigurojë se baza e të dhënave dhe bilanci përfundimtar për L.I.A të jetë i përditësuar me saktësi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2021, ishte 18,572.31€ . Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2022.

Çështja A2 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja Me nenin 39 të LMFP, kërkohet që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallrat dhe shërbimet, shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Nga testimi i pesë (5) mostave kemi vërejtur se në dy (2) raste me vlerë 12,580€, faturat nuk janë paguar brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Vonesat kryesisht janë prej 30 ditë deri në 90 ditë përtej afatit të paraparë ligjor.

Shkaku i mos pagesave me kohë ishte mungesa e mjeteve.

Ndikimi Mos pagesa e obligimeve brenda afatit ligjor rrit mundësinë që furnitorët të drejtohen përmbauesve dhe gjykatave të cilat krijojnë shpenzime shtesë për buxhetin e komunës.

Rekomandimi A2 Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor dhe porositja e mallrave, punëve apo shërbimeve bëhet vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	3,643,263	3,764,112	3,174,758	4,254,903	3,604,955
Grante Qeveritare - Buxheti	3,228,964	3,094,323	3,041,858	3,784,073	3,359,236
Financimi përmes huamarrjes	0	4,436	4,436	11,025	11,537
Të bartura nga viti i kaluar	0	247,604	25,350	312,228	106,215
Të hyrat vetanake	414,299	414,299	99,666	123,954	127,967
Donacionet e jashtme	0	3,449	3,449	23,624	0

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 120,848 €. Kjo rritje është rezultat i të hyrave vetanake të bartura nga viti i kaluar 247,604€, nga huamarrja 4,435€, nga donacionet e jashtme 3,449€, ndërsa në buxhetin final në raport me buxhetin fillestar kemi zvoglim të grantit qeveritar për shumën 134,640€.

Në vitin 2021 komuna ka shpenzuar 84% të buxhetit përfundimtar, me një ulje prej 3% në krahasim me vitin 2020. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit në nivel të përgjithshëm mbetet i kënaqshëm, me përjashtim tek kategoria e investimeve kapitale ku realizimi i buxhetit është në nivel të ulët rreth 44% dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	3,643,263	3,764,112	3,174,758	4,254,903	3,604,955
Pagat dhe mëditjet	2,355,400	2,226,095	2,224,259	2,181,916	2,142,704
Mallrat dhe shërbimet	449,730	484,263	455,380	396,570	394,997
Komunalitë	90,625	90,625	72,001	64,385	71,859
Subvencionet dhe transferet	45,000	74,299	31,500	236,332	31,300
Investimet Kapitale	702,508	888,829	391,618	1,375,700	964,096

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë: (Përshkrimet të renditen konform radhitjes në tabelën e mësipërme);

- Pavarësisht që buxheti për investime kapitale ishte rritur gjatë vitit 2021, vetëm 44% e buxhetit ishte shpenzuar, pesë (5) projekte në vlerë prej 315,000€ të cilat ishin planifikuar me buxhet, nuk janë realizuar në vitin 2021, arsytet e mosrealizimit janë: projekti Hartimi i projekteve të detajuara me vlerë 30,000€ ndodhet në OSHP, projekti participimi i përbashkët 30,000€ nuk ka filluar sepse nuk ka participues, Hartimi i mapës zonale, punët janë përfunduar mirëpo OE ka pasur vonesë në kryerjen e projektit ndersa projektet e tjera nuk kanë filluar për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore sepse ato parashihen të financohen nga të hyrat vetanake;
- Buxheti final për Paga dhe Mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 129,305€, ndërsa shpenzimi për këtë kategori ishte 99%;
- Buxheti final për Mallra dhe Shërbime, dhe Komunalitë në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 34,533€, kjo rritje është nga të hyrat vetanake të bartura nga viti i kaluar, ndërsa shpenzimi për këtë kategori ishte 92%;
- Buxheti final për Subvencione dhe Transfere, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 29,299€, kjo rritje është nga të hyrat vetanake të bartura nga viti i kaluar, ndërsa shpenzimi për këtë kategori ishte 42%;
- Po ashtu komuna ka pranuar donacione gjatë vitit 2021 në vlerë prej 3,449€, të cilat edhe janë shpenzuar, për blerjen e pasurive jo financiare; dhe
- Mjetet e shpenzuara në vitin 2021 për Rimëkëmbjen Ekonomike ishin 51,507€, ato kryesisht ishin ndarë për shtesa në arsim dhe shëndetësi.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga komuna ë Shtërpces në 2021 ishin në vlerë 353,361€€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga regjistrimi i trashëgimise, taksat administrative,etj. Përveç të hyrave të lartpërmendura, Komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat mblidhen nga niveli qendror në vlerë prej 56,982€ (gjobat në trafik 38,429€, gjobat nga Agjencia e pyjeve 17,082€, si dhe nga Gjykata 1,470€).

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	414,299	414,299	353,361	232,753	318,182
Të hyrat tatimore	327,821	327,821	223,119	169,995	182,612
Të hyrat jo tatimore	86,478	86,478	130,242	62,758	135,570

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 ka rezultuar në shtatë (7) rekomandime. OB kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, tre (3) rekomandime janë zbatuar, dhe katër (4) nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën katër (4) (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë që zyrtarët përgjegjës të komunës në bashkëpunim e me Ministrinë e Financave bëjnë rregullimet e gabimeve në bazën e të dhënave për tatim në pronë në pajtim me ligjet dhe rregulloret.	Komuna ka marrë masa për ta adresuar këto rekomandim.	I zbatuar

2.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj që zyrtarët përgjegjës janë duke i kryer detyrat dhe përgjegjësitë në lidhje me faturimin e taksës së biznesit dhe dorëzimin e faturave/aktvendimeve të subjektet afariste.	Janë ndërmarrë veprime nga menaxhmenti për zbatimin e këtij rekomandimi pasi ka bërë kërkesë për korrigjimin e gabimit të lëshuar, por në sistem ende nuk janë bërë përmirësimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës. Mbledhja e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës	Komuna ka marrëmasa për ta adrsaurë këtë rekomandim.	I zbatuar
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar të jetë meritore në mënyrë që të jenë në gjendje të përmbushin detyrat e kërkuara.	Komuna ka marrëmasa për ta adrsaurë këtë rekomandim.	I zbatuar
5.	Pasuritë	Kryetari duhet të analizoj arsyet se pse nuk janë kryer veprimet e përcaktuara me vendim dhe të kërkoj përgjegjësi nga zyrtarët përgjegjës të emëruara në ato komisione në lidhje me inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive. Raporti i inventarizimit duhet të përgatitet para hartimit të PFV-ve me qëllim të krahasimeve dhe prezantimit të gjendjes reale të pasurisë komunale.	Nuk ka filluar të implementohet ky rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që kërkesat për blerjen e pajisjeve dhe planifikimi i nevojave për prokurim të jenë analizuar mirë dhe në përputhje me krijimin e parakushteve për funksionalizimin e tyre, duke pasur parasysh gjithnjë vlerën për parane. Më tutje, duhet të merren masa urgjente që të krijohen parakushtet që pajisjet që gjenden në depo dhe ndërtesat e banimit sociale të futen sa më shpejt në përdorim.	Këtë vit kemi gjendjen pothuajse të njëjtë me përjashtim të vlerës së blerjes së pajisjeve e cila ishte më e vogël.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë dhe taksat në biznes, dhe të forcojë kontrollin e brendshëm për mënjanimin e rritjes së vazhdueshme të tyre.	Nuk janë ndërmarrë veprime nga menaxhmenti.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm




Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Ejup Simnica, Udhëheqës i ekipit



Milos Petrovic, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Shtërpcës, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem/ nuk pajtohem/ pajtohem pjesërisht/ me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.



Z. Dalibor Jevtić
Kryetar i Komunës Shtërpcës,
Data: 20.04.2021, Shtërpcë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.